



TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve përmes Likuidim Nr.69

Njësia e Vendosur në Tender Nr.01

Agrokultura Furra e vjetër në Stantërg

Emri i NSH.-së	NSH KB "Agrokultura" Mitrovicë, Fi-1604/10 ("Ndërmarrja")
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Më 30.10.2024, nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Regjistrimi i Ofertuesit	Nuk ka para-kualifikim
Depozita e Ofertës	5,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	<p>Aseti gjendet në Stantërg, (në afërsitë e muzeut të vjetër të Trepçës dhe qendrës mjekësore të lokalitetit Stantërg).</p> <p>Shikoni këtë pronë në Google Maps 1 Shikoni këtë pronë në Google Maps 2</p> <p><i>Të dhënat e hartës ©2024 Google</i></p> <p>Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.</p>
Përshkrimi i Aseteve	<p>KB Agrokultura Furra e vjetër në Stantërg, përbëhet prej tokës dhe objekteve me sipërfaqe të përgjithshme prej 530 m².</p> <p>Sipas certifikatës së pronës, njësia kadastrale 00260-0 me sipërfaqe 200m² është tokë ndërtimore me shfrytëzimin aktual të parcelës si shtëpi-ndërtesë. Njësia kadastrale 00261-0 është me sipërfaqe 229m² tokë bujqësore me shfrytëzimin aktual kullësorë e klasës 5; njësia kadastrale 00259-2 me sipërfaqe 40m² tokë ndërtimore me shfrytëzimin aktual truall si dhe njësia kadastrale 00147-0 me sipërfaqe 61m² tokë ndërtimore me shfrytëzimin aktual shtëpi-ndërtesë.</p> <p>Asetet gjenden në dy lokacione të ndara, gjegjësisht ish objekti Furra e vjetër ndodhet mbi parcelën 260-0 në afërsi me parcelat 261-0 dhe 259-0, ndërsa parcela 00147-0, ku është edhe një objekt pothuaj gërmadhë, gjendet afër objektit të Qendrës Mjekësore në Stantërg, rreth 500 metra larg nga ish Furra e vjetër e parcelat e lartpërmendura.</p>
Ndërtesat dhe tokat	<p>Sipas raportit nga terreni objektet e ndërtuar janë në gjendje të keqe teknike. Objekti i cili gjendet në parcelën 00147-0 paraqitet si një objekt pothuajse gërmadhë, edhe pse afër rrugës qasja në këtë parcelë është e vështirë për shkak të konfigurimit të terrenit. Ndërkaq, objekti i ndërtuar në parcelën 260-0, (ish furra e vjetër) i cili përfshinë gjithë parcelën, është po ashtu në gjendje të keqe. Parcelat 260-0 dhe 261-0 që paraqesin një tërësi, kanë qasje në rrugë, ndërsa</p>



	parcela 259-0 është në afërsi, por paksa e ndarë nga tërësia e dy parcelave të përmendura dhe ka pozitë më të pjerrtë.
Shfrytëzuesit	Objekti-furra e vjetër është e mbyllur.
Asetet tjera	Nuk ka asete tjera.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.



Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë du het të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.



Raporti i vizitës në terren



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VIZITE NË TERREN

NSh "Agrokultura", ZK Stan Tërg

Pjesëmarrësit: Albert Muja, UEL

Qëllimi: Identifikimi i pronave në terren, gjendjes dhe problemeve

Data: 18.07.2024¹

Në këtë Zonë Kadastrale objekt i vizitës ishin parcelat 147-0, 259-2, 260-0 dhe 261-0

Sipërfaqja			
147-0	259-2	260-0	261-0
61m ²	40m ²	200m ²	229m ²
Përshkrim ²			
Parcelat ndodhet në ZK Stan Tërg dhe parcela 147-0 është e ndarë nga parcelat tjera.			
Parcela 147 – Këtu është i ndërtuar një objekt njëkatësh, i cili në gjendjen çfarë është mund të thuhet se është një objekt gërmadhë. Edhe pse afër rrugës, qasja në këtë parcelë është e vështirë për shkak të konfiguracionit të terrenit.			
Parcelat 260-0 dhe 261-0 paraqesin një tërësi, dhe në 260-0 është i ndërtuar një objekt i cili përfshinë të gjithë parcelën. Objekti është në gjendje të keqe. Këto dy parcela kanë qasje në rrugë. Përderisa parcela 259-2 është e ndarë nga dy parcelat 260-0 dhe 261-0 (shih paraqitjen me ortofoto).			
Problemet			
Konfiguracioni i terrenit, sidomos 147-0. Objektet e ndërtuara janë pothuajse gërmadha.			
Rekomandime			
Nuk ka ndonjë rekomandim të veçantë.			

Raporti u përgatit nga:

Sali Ahmetaj

Zyrtar Kadastral, Zyra Rajonale në Mitrovicë

AKP Zyra Rajonale
Rr. Mbreteresha Teute pn,
(përballë Palestrës së Sporteve)
40 000 Mitrovicë, Kosovë,
Tel: 028 534 690
Fax: 028 534 590
e-mail: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org

¹ Ky aset është vizituar disa here, dhe vizita e fundit paraqet vizitë të rregulltë periodike

² Shih paraqitjet me ortofoto



Informatat

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400 lok. 1090,2059

Fax: +383 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Dritan Hoxha, nr.55

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Informatat rreth Njesisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilet dëshirojnë të paraqesin ofertë du het të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.